

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”

Programi i lëndës “Gjuha e huaj”  
Për Pakicat Kombëtare

SHKALLA 3 & 4



QERSHOR 2014

## 1. Hyrje

**Gjuha e Huaj** për pakicat kombëtare (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, etj.), bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i gjuhës së huaj i ndihmon nxënësit që të bëhen individë të pavarur, të lirë, të kulturuar, mendimtarë kritikë dhe krijues, njerëz të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve në gjuhë të huaj, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhët, kulturën kombëtare dhe botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësve për të bërë një komunikues të mirë, lexues aktiv e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinal dhe krijues. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë janë një nga detyrat parësore të arsimit, të cilat synojnë të përmbushin pesë kompetencat: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës.

Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë amtare, greke/maqedonase, gjuha shqipe, Gjuha e huaj.

**Gjuha amtare, greke/maqedonase, etj.**, e cila mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

**Gjuha shqipe** fillon në shkallën e parë (klasa I) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).


**Gjuha e huaj** fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Programi i gjuhës së huaj për pakicat kombëtare ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës (janë të përbashkëta për të gjitha lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”). Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës, nëpërmjet lëndës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të fushës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave.

Diagrama e mëposhtme paraqet organizimin e programit.



## **1. Qëllimet e arsimit parauniversitar**

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

## **2. Qëllimet e programit të lëndës «Gjuha e huaj»**

Qëllimet e lëndës së gjuhës së huaj për pakicat kombëtare në arsimin bazë janë:

- Zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues.
- Përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë nxënësit.
- Gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi i informacioneve

Programi mësimor i gjuhës së huaj për pakicat kombëtare, për klasat 6-7-8-9 është hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësve për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka detyrë të zhvillojë te nxënësit aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe t'i edukojë ata me të kuptuarit, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Nxënësit gjithashtu mësojnë dhe binden që gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe mjet komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulture dhe aftësish.

Duke iu referuar dokumentit Evropian, “*Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët*”, mësimi i gjuhës së huaj:

- në **klasën e gjashtë** të arsimit nëntëvjeçar, për pakicat kombëtare, zhvillohet në nivelin **A1.2+** dhe hyrje në nivelin **A2.1**, duke konsoliduar bazat fillestare të gjuhës që janë të domosdoshme për komunikim, të cilat janë dhënë në klasën e pestë.
- Në **klasën e shtatë** vazhdohet me nivelin **A2.1**,
- në **klasën e tetë** me nivelin **A2.1+ (hyrje në nivelin A2.2)** Ky është një nivel i ndërmjetëm. Nxënësit në klasën e tetë vazhdojnë në nivelin A2.1 (+), e përfundojnë atë dhe vetëm futen në nivelin A2.2. dhe
- në **klasën e nëntë** me nivelin **A.2.2 (përdorues i pavarur, niveli prag)**

Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të ndryshme, pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimimit të gjuhës së huaj është më e lartë dhe mësimi i gjuhëve të huaja lidhet me problemet e formimit e të ardhmes së tij si qytetar evropian. Zotërimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon në zgjerimin e dijeve në fusha të tjera. Përvetësimi i gjuhës së huaj kontribuon jo vetëm në pasurimin dhe në lulëzimin e individualitetit të nxënësit, por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijimit të një qytetari të ri evropian.

### 3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës


Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënës. ***Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.*** Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënës të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatit/et e të nxënës për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxënës për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultatit/et e të nxënës për shkallë, për kompetencat kyçe;

- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrama e mëposhtme konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.





**Tabela: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj gjatë shkallës së tretë dhe të katërt**

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetenca kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj gjatë shkallës e tretë dhe të katërt.

Shkalla 3	Shkalla 4
<b>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi, etj. në njërin nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj);</li> <li>2. Dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me fjali të thjeshta, mbi tema të njohura, me kusht që bashkëfolësi të jetë i gatshëm të përsërisë apo riformulojë frazat e tij.;</li> <li>3. Lexon saktë me zë një tekst të shkurtër me fjalë të njohura dhe tematikë nga jeta e përditshme;</li> <li>4. Shkruan një tekst të shkurtër e të thjeshtë për një temë të njohur.</li> <li>5. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge, etj., dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët;</li> <li>6. Shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta në gjuhën e huaj dhe i përkthen në gjuhën amtare;</li> <li>7. Shkruan një kartolinë të shkurtër e të thjeshtë, një urim, plotëson një</li> </ol>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, duke dhënë përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor;</li> <li>2. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;</li> <li>3. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;</li> <li>4. Përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;</li> <li>5. Harton një tekst, deri në 120 fjalë (bazuar në imagjinatën e vet), duke vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar më parë;</li> </ol>

pyetësor me detaje personale.

### Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

1. Sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore;
2. Identifikon për një temë/ngjarje, personazhet, kohën, vendin, etj.;
3. Shprehet pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Nxënësi:

1. Përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre;
2. Analizon një punim (p.sh. artikull të shkurtër, pikturë etj.) duke gjetur pikat e përbashkëta dhe ndryshimet;
3. Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
4. Argumenton hapat të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë, supermarket, etj.;

### Kompetenca e të nxënit

Nxënësi:

1. Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/ aktivitet/detyrë, që kërkohet;
2. Pyet dhe përgjigjet lidhur me tematika nga jeta e përditshme, me një fjalor të thjeshtë;
3. Zgjidh në mënyrë të pavarur, por edhe me ndihmën e mësuesit problemin, detyrën e dhënë duke e prezantuar para të tjerëve;
4. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;
5. Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë;
6. Identifikon dhe krahason informacionet e njohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar nga jeta e përditshme duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh duke i shënuar me shenja të ndryshme);
7. Krahason përparimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar;
8. Përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara, duke hartuar një plan pune me hapa konkrete për përmirësim;
9. Prezanton për 3 minuta veten, shkollën, familjen, dëshirat, etj.,

Nxënësi:

1. Rregjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/ faktet për një temë; veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë;
2. Shfrytëzon në mënyrë efektive fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
3. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e argumentuar para të tjerëve;
4. Prezanton në mënyrë të pavarur udhëzimet /simbolet e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., për të përmbushur një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij;
5. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur, si dhe atë që është i paqartë;
6. Përdor elementet e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësim dhe për orientimin për karrierë.

me fjali të thjeshta.

### Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

1. Përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;
2. Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup;
3. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet,..etj) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi;
4. Përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, si dhe profesionin e dëshiruar;
5. Përgatit një plan pune një javor;
6. Diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.

Nxënësi:

1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme;
2. Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë;
3. Përgatit një plan pune për kryerjen e një detyre ose projekti;
4. Vlerëson dhe kritikon mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar.

### Kompetenca personale

Nxënësi:

1. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj;
2. Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkollë apo jashtë saj).

Nxënësi:

1. analizon shkaqet e një reagimi konfliktual apo emocional dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit;

### Kompetenca qytetare

Nxënësi:

1. Përcakton rregullat e punës në grup, në bashkëpunim me anëtarët e grupit;
2. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi;
3. Rrespekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive;
4. Vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

Nxënësi:

1. Praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit;
2. Reagon ndaj personave të cilët shkelin, cënojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin;
3. Përgatit në grup një aktivitet, duke përdor tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar,

<p>5. Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.</p>	<p>social etj., në shkollë apo në komunitet;</p>
<p><b>Kompetenca digjitale</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikon personazhet, kohën, vendin e një teksti të shkurtër të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), të shprehur qartë dhe ngadalë;</li> <li>2. Realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre;</li> <li>3. Përdor teknologjinë digjitale për të gjetur informacionin e nevojshëm.</li> </ol>	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënit dhe për të rritur efektivitetin në mësimnxënie;</li> <li>2. Përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë dhe për të rritur produktivitetin e tij dhe të nxënit efektiv;</li> <li>3. Bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet e telekomunikacionit bashkëpunues, për të trajtuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj.</li> </ol>

#### **4. Lidhja e gjuhës së huaj me temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënësve, të cilat ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë, me jetën dhe interesat e tyre. Në Kornizën kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.


Gjuha e huaj zhvillon te nxënësit njohjen e vlerësimin e kulturës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme. Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.



## **5. Lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera kurrikulare**

Gjuha e huaj i pajis nxënësit me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët të tjera. Kjo lëndë u mundëson atyre që të kuptojnë tekste ose mesazhe të ndryshme, të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte.

Më konkretisht, këto njohuri dhe aftësi janë dhënë në tabelën e mëposhtme:



## **6. Kompetencat e fushës**

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”, për pakicat kombëtare dhe të gjitha lëndët që bëjnë pjesë në këtë fushë realizojnë 5 kompetenca të cilat janë: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare; të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; përdorimi i drejtë i gjuhës.

### **Përshkrimi i kompetencave të fushës**

#### **a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme**

Nxënësit marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të shkruara, të folura dhe mediatike.

Më konkretisht, nxënësit kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësit ritregojnë, veçojnë idenë kryesore, dallojnë fjalët ose frazat kyçe, bëjnë konkluzione, krahasojnë ose klasifikojnë, si dhe bëjnë vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjojnë.

#### **b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar**

Nxënësit: përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

#### **c) Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare**

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, dhe vlerësimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve).

#### **d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**

Nxënësit shkruajnë për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

#### **f) Përdorimi i drejtë i gjuhës**

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathhtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kështu, nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; kanë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

### **7. Ndarja e orëve mësimore për secilën klasë**

Gjuha e huaj është lëndë e detyrueshme në arsimin bazë. Ajo zhvillohet nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë të këtij arsimit. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për shkallën e tretë (klasa 6-7) dhe shkallën e katërt (klasa 8-9), sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Bazë, për pakicat kombëtare.

Programi i gjuhës angleze për arsimin bazë, për pakicat kombëtare, përcakton raportin: Komunikim, Formim kulturor dhe Formimi gjuhësor.

Kjo krijon mundësi për formimin e aftësive dhe shprehive afatgjatë tek nxënësit.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) objektivat sipas kompetencave të përshkuara më lart ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të zënë vend aty ku përdoruesi e sheh më të arsyeshme për t'i zbatuar. Konceptimi i kapitujve të tekstit dhe njësisve mësimore është e drejtë dhe detyrë e autorit të tekstit dhe mësuesit. E rëndësishme është në këtë rast, që zbatuesit e programit të jenë të vëmendshëm në realizimin cilësor të të gjitha objektivave të përcaktuara në këtë program.

**Orët Mësimore 35 javë x 2 orë = 70 orë vjetore**

<b>SHKALLA E TRETË</b>	<b>Komunikim dhe formim kulturor</b>	<b>Formimi gjuhësor</b>	<b>Orë/vit</b>
<b>Klasa e gjashtë</b>	40 orë	30 orë	70 orë
<b>Klasa e shtatë</b>	40 orë	30 orë	70 orë
<b>Total</b>	<b>80 orë</b>	<b>60 orë</b>	<b>140 orë</b>
<b>SHKALLA E KATËRT</b>	<b>Komunikim dhe formim kulturor</b>	<b>Formimi gjuhësor</b>	<b>Orë/vit</b>
<b>Klasa e tetë</b>	40 orë	30 orë	70 orë
<b>Klasa e nëntë</b>	40 orë	30 orë	70 orë
<b>Total</b>	<b>80 orë</b>	<b>60 orë</b>	<b>140 orë</b>

Koha mësimore për çdo kompetencë përdoret: **60- 70%** për njohuri të reja dhe **30 -40 %** përpunim njohurish, projekte, vlerësim, etj. Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të një kompetence.



**Kompetenca: Të dëgjuarit**

<p><b>Përshkrimi i kompetencës</b></p> <p>● Nxënësi mund të kuptojë shprehje dhe një fjalor shumë të përdorshëm që lidhet me atë që i përket (veten, familjen, blerjet, mjedisin e afërt e të njohur). Mund të kapë thelbin e lajmërimeve, të mesazheve të thjeshta dhe të qarta.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregon se kupton pikat kryesore dhe mendimet të shprehura në pasazhe të përbëra nga materiale të njohura nga kontekste të ndryshme, duke përfshirë ngjarje të ditës apo të ardhme;</li> <li>- Ata mund të kenë nevojë për disa përsëritje.</li> </ul>	
<p><b>Njohuritë për realizimin e kompetencës</b></p>	<p><b>Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës</b></p>
<p><b>Njohuritë për klasën e gjashtë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehje dhe një fjalor të përdorshëm që</li> </ul>	<p><b>Të dëgjuarit</b></p>

<p>lidhet me shijet, preferencat, mjedisin, kohën, etj. (veten, familjen, blerjet, mjedisin e afërt);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emri, adresa, moshë, etj.;</li> <li>• Aktivitetet në kohën e lirë dhe preferencat e tij;</li> <li>• Udhëzime të thjeshta për të shkuar nga një vend në tjetrin, në këmbë ose me mjete të transportit publik;</li> <li>• Shifra, numra telefoni, çmime.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon dhe reagon ndaj fjalive të thjeshta, të artikuluar ngadalë dhe me gjuhë të qartë;</li> <li>• Identifikon objekte të ndryshme, kur ato dëgohen, përmenden apo tregohen;</li> <li>• Reagon përmes veprimtarive fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit apo të njerëzve që e rrethojnë;</li> <li>• Reagon kur dëgjon modele të caktuara që shprehin ndjenja, aprovim apo refuzim;</li> </ul>
<p><b>Njohuritë për klasën e shtatë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjali të thjeshta mbi vendndodhjen;</li> <li>• Histori të thjeshta, ngjarje të thjeshta në kohën e tashme, të shkuar apo të ardhme;</li> <li>• Pjesë të incizuara, me kusht që folësi të jete i qartë dhe me ritëm të ngadaltë;</li> <li>• Përshkrimi i një personi/sendi;</li> <li>• Numrat deri në njëmijë;</li> <li>• Kuptimi i mesazheve në ambiente të ndryshme publike, si aeroport, supermarket,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton fraza, fjali dhe shprehje që lidhen me fushat e interesit të tyre, informacione për veten, familjen shokët, vendbanimin, klasën, shkollën;</li> <li>• Kupton dhe komenton fakte të ndryshme;</li> </ul>

stacion treni, etj.	
<b>Të dëgjuarit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studime tekstesh të tilla si: dialogë të shkurtër, dramatizime të ndryshme, përralla, shfaqje për fëmijë, rregulla praktike etj.</li> </ul>	
<b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b>	
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon; nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur; e sheh në sy personin gjatë kohës që flet; shpreh pëlqim dhe interes ndaj asaj që dëgjon, duke reaguuar</li> </ul>	

### **Kompetenca: Të folurit**

#### **Përshkrimi i kompetencës**

- Nxënësi mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta dhe të zakonshme, të cilat kërkojnë një shkëmbim informacioni të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë mbi tema dhe veprimtari të njohura. Përshkruan me terma të thjeshta familjen, njerëzit e tjerë, kushtet e jetesës, ambientin.



## Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të folurit

Nxënësi:

- Shprehet nëse është dakord apo jo, kur i kërkohet mendim për një çështje të njohura;
- Flet kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka etj;
- Diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;
- Përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;
- Merr pjesë në lojë me role;

### Njohuritë për realizimin e kompetencës

### Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës

#### Njohuritë për klasën e gjashtë

- Prezantim i vetes dhe shokut;
- Përshkrimi i vetvetes, ambientit familiar, shijet;
- Përshkrim i një ngjarjeje;
- Dhënia e një opinioni pozitiv ose negative;
- Komentimi i disa fakteve;
- Projekte personale;

#### Të folurit

- Nxënësi:
- Përshkruan kohën e lirë;
- Tregon se çfarë ka bërë gjatë një fundjave;
- Vlerëson, krahason, objekte dhe persona;
- Bën projekte personale;
- Bën zgjedhje dhe justifikon zgjedhjet e tij.

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosja në kohë dhe hapësirë, etj.</li> </ul>	<p><i>Të folurit ndërveprues</i></p>
<p><b>Njohuritë për klasën e shtatë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ritregimi i një ngjarjeje në kohën e shkuar dhe të ardhme;</li> <li>• Nevojat dhe domosdoshmëritë;</li> <li>• Dhënie dhe kërkim i një informacioni të nevojshëm;</li> <li>• Shpjegimi i funksionit të një objekti;</li> <li>• Njohuri rreth artit kulinar;</li> <li>• Veshjet dhe stili i të veshurit;</li> <li>• Punët e shtëpisë;</li> <li>• Shtetet dhe klima;</li> <li>• Numrat deri në një milion.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr dhe jep këshilla mbi aspekte të jetës së përditshme si këshilla për të kaluar fundjavën, pushimet verore;</li> <li>• Flet për familjen, miqtë në një diskutim me miqtë e tij;</li> <li>• Bën dhe pranon një ftesë;</li> <li>• Diskuton dhe sugjeron programin e një mbrëmjeje;</li> <li>• Diskuton për një eveniment kulturor;</li> <li>• Pyet dhe kërkon sende që i nevojiten për të kryer një punë;</li> <li>• Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve për veten, familjen, shkollën dhe vendbanimin;</li> <li>• Pyet dhe shpjegon funksionin e një objekti;</li> <li>• përdor fjali të thjeshta për të shprehur ndjenja, dëshira, për të dhënë informacione dhe për të bërë përshkrime;</li> <li>• Vlerëson, krahason dikë ose diçka.</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh fjalorit e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes).</li> </ul>	

## Kompetenca: Të lexuarit

<b>Përshkrimi i kompetencës</b> <ul style="list-style-type: none"><li>● Nxënësi mund të lexojë tekste të thjeshta dhe të shkurtra. Mund të gjejë një informacion të veçantë të parashikueshëm në dokumente të përditshme, si reklama, fletëpalosje, meny ose orare dhe mund të kuptojë letra dhe mesazhe personale, të shkurtra dhe të thjeshta.</li></ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të lexuarit</b> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;</li><li>• lexon me zë një tekst të shkurtër dhe identifikon personazhet, vendndodhjen dhe kohën e ngjarjes;</li><li>• ritregon ngjarjen në mënyrë koherente;</li><li>• jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar dhe joletrar.</li></ul>	
<b>Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë dhe shkathtësitë</b>
<b>Njohuritë për klasën e gjashtë</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• dallimi i tabelave në vende publike, si rrugë, stacion, shkollë, supermarket, etj.;</li><li>• dallimi i të dhënave personale, emër, adresë,</li></ul>	<b>Të lexuarit fillestar</b> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Lexon dhe kupton tabelat në vende publike;</li></ul>

<p>ditëlindje, në një formular ose pyetësor të thjeshtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kuptimi i një mesazhi të thjeshtë ose një ftese apo kartoline;</li> <li>• kuptimi i të dhënave kryesore në një meny, njoftim, orar, një faqe interneti, etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon tekste që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj;</li> <li>• Kupton një mesazh të thjeshtë, si sms, e-mail, etj.;</li> <li>• Lexon mesazhe të thjeshta që i drejtohen me kartolinë, letër, rreth pushimeve apo festave familjare.</li> </ul>
<p><b>Njohuritë për klasën e shtatë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i mënyrës së përdorimit (udhëzuesi) të një aparati të thjeshtë, si aparat fotografik, magnetofon, etj.;</li> <li>• Njohuri të thjeshta për artin kulinar;</li> <li>• Kuptimi i pikave kryesore në një tregim me temë familjare ose shoqërore;</li> <li>• Kuptimi i një rubrike të veçantë në një gazetë ose dokument, si informacion kulturor, sportiv, etj.</li> </ul>	<p><b>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti, ose rreth fjalëve të panjohura për të (Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?);</li> <li>• rilexon tekstin për të kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme);</li> <li>• dallon të dhëna personale në një pyetësor;</li> <li>• identifikon mesazhe, komente të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë;</li> <li>• lexon dhe kupton tekste të thjeshta me gjuhë jo shumë të ngarkuar. (me ndihmën e fjalorit).</li> </ul> <p><b>Të lexuarit e teksteve letrare</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lexon vjersha, përralla, tregime të shkurtra, etj;</li> <li>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe jep mendimin e tij;</li> </ul> <p><b>Të lexuarit e teksteve joletrare</b></p>

	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lexon tekste joletrare si: udhëzime, kartolina, reklama, etj.;</li> <li>• dallon pjesët përbërëse të një tregimi, hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen;</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon;</li> <li>• lexon me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë.</li> </ul>	

**Kompetenca: Të shkruarit**

<p><b>Përshkrimi i kompetencës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Nxënësi mund të mbajë shënime dhe shkruan mesazhe të thjeshta dhe të shkurtra, mund të shkruajë një letër personale falënderimi, të shkurtër dhe të thjeshtë.</li> </ul>
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të shkruarit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkruan në një letër atë që i ka ndodhur në një të shkuar të afërt ose të largët;</li> <li>• shkruan tekste të thjeshta për të bërë një ftesë ose propozim. (letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.</li> </ul>

**Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës**

**Njohuritë**

**Aftësitë dhe shkathtësitë**

**Njohuritë për klasën e gjashtë**

- Shkrimi i një mesazhi ose letre të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje;
- Përshkrimi në një letër personale i familjes, vendit ku banon, kohës dhe me se merret;
- Përshkrimi i shtëpisë, punët shtëpiake dhe mobilimi;
- Përshkrimi i artikujve ushqimorë, i një recete guzhine, shijeve, preferencave, etj.;
- Përshkrimi i një personi duke dhënë detaje për veshjen, karakterin, etj.;
- Përshkruan itinerarin e një udhëtimi.

Nxënësi:

- Përshkruan në një letër personale familjen, vendin ku banon, kohën dhe me se merret;
- Përshkruan një person duke dhënë detaje për veshjen, karakterin, etj.;
- Përshkruan itinerarin e një udhëtimi;
- Shkruan një recetë guzhine.

**Të shkruarit si produkt**

Nxënësi:

### Njohuritë për klasën e shtatë

- Përshkrim i thjeshtë për njerëzit, vendin, studimet e tij.;
- Përshkrim i thjeshtë i asaj që dëshiron të bëjë në një të ardhme të afërt;
- Përshkrim i thjeshtë i një ngjarjeje të ndodhur në një të shkuar të largët ose të afërt.

- Përshkruan kujtimet e fëmijërisë;
- Përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;
- Rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?* etj.;
- Jep përshtypjet e një udhëtimi;
- Shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku;
- Harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor;
- Redakton një kritikë pozitive ose negative mbi një libër, film, ngjarje, etj.
- Dallon dhe zgjedh fjalë të përshtatshme për të plotësuar vende bosh në fjali;
- Etiketron objektet përreth.

### Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Nxënësi:

- Mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan.

### Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

#### Përshkrimi i kompetencës

- Nxënësi në fund të këtij niveli mund të kuptojë fjali të shkëputura dhe shprehje të përdorura shpesh në lidhje me fusha që kanë përparësi imediate, (si informacione personale ose familjare të thjeshta, blerje, mjedisi më i afërt, etj.) mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta, të zakonshme që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë informacionesh të thjeshta e të drejtpërdrejta, mbi tema të njohura dhe të zakonshme.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencën e përdorimit të drejtë të gjuhës

Nxënësi:

- Dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme;
- Zgjedhon folje të rregullta dhe të parregullta, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna;
- Përdor përemrat dëftor, lidhorë.



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mbiemrat cilësorë, pronorë, dëftorë, etj.</li> </ul>	
<b>Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencave të lëndës</b>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë dhe shkathtësitë</b>
<b>Njohuritë për klasën e gjashtë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjedhimi i foljeve të rregullta e të parregullta në kohë të thjeshta e të përbëra, në mënyrën dëftore;</li> <li>• Riprodhimi i formave të gatshme gjuhësore;</li> <li>• Numërorët themelorë dhe rreshtorë;</li> <li>• Emrat e numërueshëm e të panumërueshëm;</li> <li>• Shkallët e krahasimit të mbiemrave;</li> <li>• Ndajfoljet dhe formimi i tyre.</li> </ul>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor numrat dhe shifrat në situata të ndryshme;</li> <li>• Përdor në fjali emrat e numërueshëm e të panumërueshëm</li> <li>• Përdor në përshkrime kohën e pakryer;</li> <li>• Dallon emrat e numërueshëm e të panumërueshëm, duke vendosur nyjen përkatëse;</li> <li>• Përdor lidhëzat më të rëndësishme për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve;</li> <li>• Përdor në fjali dhe situata të caktuara ndajfoljet e mënyrës, sasisë, kohës, vendit, etj.;</li> <li>• Përdor dhe riprodhon shumësin e emrave të rregullt e të parregullt,</li> </ul>

<p><b>Njohuritë për klasën e shtatë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuri fillestare për kohën e pakryer të foljeve;</li> <li>• Dallimi i pjesëve kryesore të ligjëratës;</li> <li>• Përdorimi i parafjalëve dhe lidhëzave më të rëndësishme për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve;</li> <li>• Zgjedhimi dhe përdorimi foljeve të rregullta e të parregullta në kohët e tashme, të shkuar dhe të ardhme;</li> <li>• Ndajfoljet e mënyrës, sasisë, vendit, kohës, etj.;</li> <li>• Shumësi i emrave, përemrat vetorë, dëftorë, pyetës, lidhor, etj;</li> <li>• Njohuri fillestare për mënyrën kushtore.</li> </ul>	<p>përemrat vetor, dëftor, pyetës e lidhor, etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon dhe zgjedhon foljet në kohë të thjeshta, etj.</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b></p>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• paraqet dhe komunikon me gjuhë të thjeshtë mendimet e tij;</li> <li>• demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;</li> <li>• demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;</li> <li>• respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.</li> </ul>	



**Kompetenca: Të dëgjuarit**

<p><b>Përshkrimi i kompetencës</b></p> <p>● Nxënësi mund të kuptojë pikat themelore kur përdoret një gjuhë e qarte dhe standarde dhe nëse behet fjale për tema të njohura që kanë lidhje me punën, shkollën, kohën e lire, etj. Mund të kuptojë thelbin e një numri emisionesh në radio ose televizion mbi aktualitetin ose mbi tema që i interesojnë personalisht drejtpërdrejtë ose nga ana profesionale nëse flitet ngadalë dhe qartë.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregon se kupton pikat kryesore dhe mendimet të shprehura në pasazhe të përbëra nga materiale të njohura nga kontekste të ndryshme, duke përfshirë ngjarje të kaluara, të ditës apo të ardhme.</li> </ul>	
<p><b>Njohuritë për realizimin e kompetencës</b></p>	<p><b>Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës</b></p>
<p><b>Njohuritë për klasën e tetë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehje dhe një fjalor shumë të përdorshëm</li> </ul>	<p><b>Të dëgjuarit</b></p>

<p>që lidhet jetën e përditshme, me atë çka i përket shijet, preferencat, mjedisin, kohën, hobet, etj. (veten, familjen, blerjet, mjedisin e afërt);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mesazhe ne ambiente te ndryshme publike, si ne aeroport, supermarket, stacion treni, etj.;</li> <li>• Aktivitetet në kohën e lirë dhe preferencat e tij.;</li> <li>• Udhëzime të thjeshta për të shkuar nga një vend në tjetrin, në këmbë ose me mjete të transportit publik;</li> <li>• Shifra, numra telefoni, çmime., etj.;</li> <li>• Tipet e programeve televizive;</li> <li>• Marrëdhëniet familjare, etj.;</li> <li>• Ndjenja personale;</li> <li>• Mësimi dhe shkolla, rregullat e shkollës;</li> <li>• Jeta personale dhe shoqërore;</li> <li>• Planifikimi i një mbrëmjeje;</li> <li>• Bota rreth nesh;</li> <li>• Probleme të ambientit;</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton shprehje dhe një fjalor shume të përdorshëm që lidhet me çka i përket personalisht, familjes, shoqërisë, blerjet, etj.;</li> <li>• Kap thelbin e lajmërimeve, te mesazheve te thjeshta dhe te qarta;</li> <li>• Reagon përmes veprimtarive fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit apo të njerëzve që e rrethojnë;</li> <li>• Rupton fraza, fjali dhe shprehje që lidhen me fushat e interesit të tyre, informacione për veten, familjen shokët, vendbanimin, klasën, shkollën;</li> <li>• Kupton dhe komenton fakte të ndryshme;</li> <li>• Kupton pjese te incizuara me kusht qe folësi të flasë ngadalë dhe qartë;</li> <li>• Kupton në një histori të thjeshtë, ngjarje të së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes;</li> <li>• Kupton mesazhe në ambiente të ndryshme publike, si në aeroport, supermarket, stacion treni, etj.;</li> <li>• Kupton thelbin ne tema te njohura si puna, shkolla, argëtimet;</li> </ul>
--	--

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësitë shoqërore;</li> <li>• Bota e komunikimit;</li> <li>• Ngjarje aktuale;</li> <li>• Etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton mesazhe televizive, radiofonike mbi tema te njohura;</li> <li>• Kupton një guidë turistike nëse flitet qartë;</li> <li>• Reagon ndaj një informacioni nga pjesë të incizuara me kusht që folësi të artikulojë materialin ngadalë dhe me gjuhë të qartë;</li> </ul>
<p><b>Njohuritë për klasën e nëntë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjali të thjeshta mbi vendndodhjen;</li> <li>• Histori të thjeshta, ngjarje të thjeshta në kohën e tashme, të shkuar apo të ardhme;</li> <li>• Pjesë të incizuara, me kusht që folësi të jete i qartë dhe me ritëm të ngadaltë;</li> <li>• Përshkrimi i një personi/sendit;</li> <li>• Veprime matematikore, mbledhje, zbritje, etj.;</li> <li>• Kuptimi i mesazheve në ambiente të ndryshme publike, si aeroport, supermarket, stacion treni, etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon përshkrimin e thjeshtë të një personi apo vendi dhe disa veçorive dalluese</li> </ul>
<p><b>Të dëgjuarit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste të hartuara kryesisht në një gjuhë të</li> </ul>	

<p>përditshme që lidhen me punën e nxënësit. Kuptimi i përshkrimit të ngjarjeve, shprehja e ndjenjave dhe të urimeve në letra personale.</p>	
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon; nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur; e sheh në sy personin gjatë kohës që flet; shpreh pëlqim dhe interes, keqardhje ndaj asaj që dëgjon, duke reaguar</li> </ul>	

### **Kompetenca: Të folurit**

<p><b>Përshkrimi i kompetencës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Nxënësi mund të përballojë shumicën e situatave në të cilat mund të gjendet gjatë një udhëtimi në një zonë ku flitet gjuha. Mund të marrë pjesë pa u përgatitur në një bisedë me tema të njohura ose për të cilat ka interes vetjak, apo që kanë lidhje me jetën e përditshme (si koha e lire, familja, shkolla, puna, udhëtimet dhe aktualiteti)</li> </ul>
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të folurit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• flet kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, në kohe të ndryshme, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka etj;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe argumenton mendimet e tij;</li> <li>• Mund të shprehet në mënyre të thjeshtë për të treguar veprimtari dhe ngjarje, ëndrra, shpresa apo qëllime;</li> <li>• Mund të tregojë thelbin e një historie apo libri dhe të shprehë reagimet e tij.</li> </ul>	
<b>Njohuritë për realizimin e kompetencës</b>	<b>Aftësitë dhe shkathhtësitë për realizimin e kompetencës</b>
<b>Njohuritë për klasën e tetë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Jeta e përditshme;</li> <li>• Familja, rregullat e përgjegjësitë;</li> <li>• Bota përreth, fqinjët;</li> <li>• Çështje të ruajtjes së ambientit, ndotja, ngrohja globale, ndryshimet klimaterike;</li> <li>• Bota e komunikimit;</li> <li>• Artet, etj.</li> </ul>	<b>Të folurit</b> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan kohën e lirë, aktivitete, familjen, vendin ku banon, festa, etj.;</li> <li>• Vlerëson, krahason, objekte dhe persona;</li> <li>• Bën projekte personale;</li> <li>• Bën zgjedhje dhe justifikon zgjedhjet e tij;</li> <li>• Shpreh preferenca;</li> <li>• Këshillon, bën një kërkesë ose ofertë, etj.</li> </ul>
<b>Njohuritë për klasën e nëntë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantimi dhe shoqërizimi;</li> <li>• Shprehja e inkurajimit (shumë mirë, të lumtë...);</li> </ul>	<b>Të folurit ndërveprues</b> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• kupton dhe reagon duke diskutuar mbi veprimtaritë e preferuara,</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehja e preferencave (më pëlqen... urej...);</li> <li>• Paraqitja e një kërkesë ose oferte, (... a mund, mundem...)</li> <li>• Këshillimi rreth diçkaje;</li> <li>• Aprovimi ose mosaprovimi, refuzimi... (jam dakord, e ke gabim...);</li> <li>• Kërkim informacioni;</li> <li>• Diskutim i një plan udhëtimi;</li> <li>• Krahasimi i ndryshimeve;</li> <li>• Shprehja e një qëllimi;</li> <li>• Dhënia e arsyeve të ndryshme për një veprim;</li> <li>• Kërkesë për sqarime të mëtejshme;</li> <li>• Shprehje e sugjerimeve (mendoj, po sikur...);</li> <li>• Lajmërim e paralajmërim (sigurohu, bëhu gati...);</li> <li>• Dhënie e një porositje, sugjerimi;</li> <li>• Preferencat për profesionin, modën, artet, sportin, etj.</li> </ul>	<p>shijet, miqtë dhe shkollën me fjali të lidhura saktë dhe thjesht;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan thjesht dhe shkurt përvoja personale të pushimeve apo veprimtari të ndryshme të ndodhura në të shkuarën;</li> <li>• diskuton mbi planet me shokët duke sugjeruar alternativa personale;</li> <li>• Merr dhe jep këshilla mbi aspekte të jetës së përditshme si këshilla për të kaluar fundjavën, pushimet verore.</li> <li>• Flet për familjen, miqtë në një diskutim me miqtë e tij;</li> <li>• Bën dhe pranon një ftesë;</li> <li>• Diskuton për një eveniment kulturor;</li> <li>• Pyet dhe kërkon sende që i nevojiten për të kryer një punë;</li> <li>• Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve për veten, familjen, shkollën dhe vendbanimin;</li> <li>• Pyet dhe shpjegon funksionin e një objekti.</li> </ul> <p><b><i>Prodhim i të folurit</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkon dhe jep këshilla dhe sugjerime duke ndjekur modele mirësjelljeje por edhe duke përshtatur e riformuluar mesazhin;</li> <li>• Shpreh dëshirat e tij mbi të tashmen dhe të ardhmen lidhur me çështje të tilla si profesioni, blerjet, veprimtaritë, duke përdorur shprehje të gatshme.</li> </ul>
--	---



<b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b>	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh fjalorit e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes).</li> </ul>	

### **Kompetenca: Të lexuarit**

<b>Përshkrimi i kompetencës</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>● Nxënësi mund të kuptojë tekste të hartuara kryesisht në një gjuhë të përditshme që lidhen me punën e tij. Mund të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, shprehjen e ndjenjave dhe të urimeve në letra personale.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të lexuarit</b>
Nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të kuptojë thelbin e një tregimi të shkurtër, të strukturuar qartë,</li> <li>• Mund të gjejë një informacion të caktuar në një tekst të gjatë (letër, tregim, artikull...), p.sh. vendin ku ndodh ngjarja, kohën, personazhet, etj.,</li> <li>• Mund të kuptojë detaje të përdorimit të një aparati të përditshëm, si kompjuter, MP3 I-pod, playstation;</li> <li>• ritregon ngjarjen në mënyrë koherente;</li> </ul>

<b>Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë dhe shkathtësitë</b>
<p><b>Njohuritë për klasën e tetë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>dallimi i të dhënave personale, emër, adresë, ditëlindje, në një formular ose pyetësor;</li> <li>kuptimi i një mesazhi, një ftese apo kartoline;</li> <li>kuptimi i të dhënave kryesore në një meny, njoftim, orar, një faqe interneti, etj.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Lexon tekste që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj;</li> <li>Kupton një mesazh të thjeshtë, si sms, e-mail, etj.;</li> <li>Dallon të dhëna personale në një pyetësor;</li> <li>Identifikon mesazhe, komente shumë të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë;</li> <li>Lexon dhe kupton tekste të thjeshta me gjuhë jo shumë të ngarkuar;</li> <li>Dallon informacionin bazë dhe disa detaje në një tregim që trajton temë të njohur me fjalor përgjithësisht të trajtuar më parë;</li> <li>Identifikon mesazhin kyç në një njoftime, faqe interneti;</li> </ul>
<p><b>Njohuritë për klasën e nëntë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Jeta e përditshme;</li> <li>Jeta e nxënësit, ndjenja, opinione, ide, moda, sporti;</li> <li>Shoqëria dhe miqësia;</li> <li>Udhëtimet;</li> <li>Profesionet;</li> <li>Bota rreth nesh, ambjenti;</li> <li>Kuptimi i mënyrës së përdorimit (udhëzuesi) të një aparati të thjeshtë, si aparat fotografik, magnetofon, etj.;</li> <li>Të ushqyerit dhe shëndeti;</li> </ul>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi i pikave kryesore në një tregim me temë familjare ose shoqërore.</li> </ul>	
<b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon;</li> <li>• lexon me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë.</li> </ul>	

### **Kompetenca: Të shkruarit**

<p><b>Përshkrimi i kompetencës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Nxënësi mund të shkruajë një tekst të thjeshtë dhe koherent mbi tema të njohura ose që i interesojnë personalisht. Mund të shkruajë letra personale për të përshkruar përvojat dhe përshtypjet e tij.</li> </ul>
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të shkruarit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkruan një tekst të thjeshtë për atë që i ka ndodhur në një të shkruar të afërt ose të largët;</li> </ul>

- shkruan tekste të thjeshta për të bërë një ftesë ose propozim. (letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.

**Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës**

**Njohuritë**

**Aftësitë dhe shkathtësitë**

**Njohuritë për klasën e tetë**

- Shkrimi i një mesazhi ose teksti koherent, të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje;
- Përshkrimi në një letër personale i familjes, vendit ku banon, kohës dhe me se merret;
- Përshkrimi i shtëpisë, punët shtëpiake dhe mobilimi;
- Përshkrimi i artikujve ushqimorë, i një recete guzhine, shijeve, preferencave, etj;
- Përshkrimi i një personi duke dhënë detaje për veshjen, karakterin, etj;
- Etj.

Nxënësi: me një fjalor më të pasur,

- Mund të shkruaj një mesazh ose një letër të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje;
- Përshkruan në një letër personale familjen, vendin ku banon, kohën dhe me se merret;
- Përshkruan një person duke dhënë detaje për veshjen, karakterin, etj.;
- Përshkruan itinerarin e një udhëtimi;
- Shkruan një recetë guzhine;
- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;

### **Njohuritë për klasën e nëntë**

- Përshkrimi i ngjarjeve në të shkuarën,
- Jeta e përditshme, rutinë, aktivitete, blerje, festime të ndryshme, ditëlindje, etj.
- Dieta dhe shëndeti,
- Rregullat në familje,
- Bota rreth nesh,
- Bota e komunikimit,
- Ambienti, ndotja, trafiku, etj.

- Mund të përshkruajë thjesht atë që dëshiroj të bëj në një të ardhme të afërt ose të largët si: shkollën që dëshiron të ndjekë, profesionin që do të ushtrojë, etj.;
- Përshkruajë shumë thjeshtë njerëzit, vendin, punën, studimet, etj.;
- Përshkruan shumë thjeshtë atë që i ka ndodhur në një të shkuar të largët ose të afërt.

### Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Nxënësi:

- Mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan.

### Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

#### Përshkrimi i kompetencës

- Nxënësi mund të kuptojë pikat themelore në një tekst me gjuhë të përditshme dhe që përmban tema të njohura për të, (si informacione personale ose familjare të thjeshta, blerje, mjedisi më i afërt, ambienti, etj.) mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta, të zakonshme që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë informacionesh të drejtpërdrejta.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencën e përdorimit të drejtë të gjuhës

Nxënësi:

- Dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme;
- Zgjedhon folje të rregullta dhe të parregullta, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna;
- Përdor përemrat lidhorë;

- Përdor mbiemrat cilësorë, pronorë, dëftorë, etj.
- Përdor ligjëratën e drejtë dhe atë të zhdrejtë.

**Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencave të lëndës**

<b>Njohuritë</b>	<b>Aftësitë dhe shkathtësitë</b>
<p><b>Njohuritë për klasën e tetë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kohët e foljeve (përsëritje nga klasat e mëparshme) ;</li> <li>• Të gjitha kohët e thjeshta e të përbëra të foljeve të rregullta e të parregullta ;</li> <li>• Kohët e foljeve në të dyja trajtat, veprorë e pësorë;</li> <li>• Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë;</li> <li>• Mënyra kushtore;</li> <li>• Foljet modale;</li> <li>• Përemrat lidhorë;</li> <li>• Përemrat e pacaktuar, reflektivë;</li> <li>• Ndajfoljet;</li> <li>• Fjalë lidhëse (sepse, megjithëse, etj.);</li> <li>• Frazologji të thjeshta foljore, etj.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor kohët e foljeve të mësuara deri tani;</li> <li>• Përdor në fjali foljet e rregullta e ato të parregullta, në kohët e thjeshta e të përbëra;</li> <li>• Bën përshkrime të ndryshme, duke përdorur foljet në të dyja trajtat, veprorë dhe pësorë;</li> <li>• Di të kthejë fjali nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë;</li> <li>• Përdor lidhëzat më të rëndësishme për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve;</li> <li>• Përdor në fjali dhe situata të caktuara foljet modale, ndajfoljet e mënyrës, sasisë, kohës, vendit, etj;</li> <li>• Përdor në fjali mënyrën kushtore;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor në fjali foljet modale për të dhënë një këshillë apo detyruar;</li> <li>• Përdor në fjali frazeologji foljore të thjeshta, me kuptim letrar dhe idiomatik;</li> </ul>
<p><b>Njohuritë për klasën e nëntë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përemrat e pacaktuar (të dy, asnjëri, tjetri, etj.);</li> <li>• Mbiemra me ndajfolje (shumë, tepër i pisët...);</li> <li>• Koha e kryer e plotë;</li> <li>• Mënyra përcjellore, Koha e kryer (kam dy orë duke studiuar);</li> <li>• Format pësore të foljeve (e tashme e thjeshtë, e shkuar e thjeshtë, e kryer, e ardhme etj. ... u festua... do të ndërtohet);</li> <li>• Ligjërata e drejtë, (kërkesa, urdhra, pohime);</li> <li>• Mënyra kushtore (...nëse shkon në muzeum do të shikosh...);</li> <li>• Folje modale (për një këshillë ose detyrim)</li> <li>• Fjalitë lidhore;</li> <li>• Frazeologji foljore të thjeshta, me kuptim letrar dhe idiomatik;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Etj.</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Etj.</li> </ul>	
<b>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</b>	
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• paraqet dhe komunikon me gjuhë të thjeshtë mendimet e tij;</li> <li>• demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;</li> <li>• demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;</li> <li>• respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.</li> </ul>	

## 8. Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve.

Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënësve dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënësve. Mësimdhënia e gjuhës së huaj duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

### **Mësimdhënie me nxënësin në qendër**

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e gjuhëve të huaja kërkon që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh do të nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

## **Integrimi**

Linjat e programit: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe njohuri rreth sistemit gjuhësor do të trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Asnjëherë nuk mund të bëhen veprimtari vetëm për njërën nga linjat e programit. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku. Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre linjave forcon cilësinë e të nxënësve të nxënësve.

## **Procesi i rimarrjes së njohurive**

Aftësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor, llojet e ndryshme të teksteve do të zhvillohen duke u rishikuar dhe rishqyrtuar vit pas viti, por në një nivel më të lartë vështirësie. Kjo do t'u mundësojë nxënësve të përparojnë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

## **9. Udhëzime për vlerësimin**

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësve. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e objektivave të programit për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së objektivave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;

### **Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre tipa kryesorë:**

**Vlerësimi diagnostikues** që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies së mësuesit dhe të nxënësit e nxënësve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

**Vlerësimi formues** është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

**Vlerësimi përmbledhës** kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësit.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon testime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimi, të cilat i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet semestrare dhe përfundimtare, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të detyrueshme.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kritereve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, mësuesi rekomandon.

Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit. Informacioni është përshkruar ose me notë. Detaje që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin bazë gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë.

## PËRMBAJTJA E SUGJERUAR

### *Kultura dhe Komunikimi*

#### **Everyday life;**

- Domestic routine;
- Food, eating and cooking;
- Abilities;
- Hobbies;
- Interests;
- Spare time;
- Sports, activities, personal preferences;
- Leisure activities;
- Time, telling the time;
- Family;
- Homes;
- The body and People.s Appearance;
- Clothes;
- Animals, pets;

#### **School life.**

- A school day;
- School subjects and time-table;

- School rules and the language of the classroom; etc.

### **Personal and social life.**

- My health (at the dentist, see a doctor, etc.);
- My family (family relations and celebrations);
- My clothes, my body;
- Physical characteristics of people;
- Seasons and weather, etc.

### **The world around us.**

- Travelling (geography, famous places etc.);
- Shopping (a shopping list, money, etc.);
- Houses and homes;
- Holidays and celebrations, etc.

### **World of communication.**

- TV programs (cartoons, films, shows, etc.)
- Radio programs (my favourite music, band, rock star, etc.)
- Sending letters, postcards, sms, e-mails, etc.

### ***Aktet dhe funksionet e komunikimit***

### **Greetings When Meeting and Parting**

- Hello! Hi!
- Good morning/afternoon/evening. Good bye/Bye.
- How are you doing? Nice to see you.
- What about.....etc.
- See you (later). Take care. Have a nice day.

### **Inquiring about one's welfare**

- How are you? How is it going?

### **Inquiring and Answering about welfare**

- Fine, thanks. I'm okay, thanks. Not (too/so) bad, thanks.

### **Introducing**

- Introducing Oneself. I'm ... . My name is ... .

#### Introducing Others

- This is my friend, ... . I'd like you to meet ... . I'd like to introduce ... to ... .\
  - Replying to an Introduction; Nice to meet you.
  - **Asking for and giving direction.**
    - Where is the cinema? Go straight on and then turn left. Etc.
  - **Asking for and giving informations.**
    - What's your favourite, sport, TV program? etc.
  - **Apologising**



- I am so sorry about .....etc.
- **Giving advice**
- You should clean your teeth twice a day. You shouldn't chew in the class.
- **Giving orders and instructions**
- Don't do that. Come here quickly, etc.
- **Making comparison.**
- As.....as (as tall as me) Like (she is like her sister) Thinner than
- The most dangerous of .....etc.
- **Offering something to someone.**
- Here you are. Here it is. Enjoy it, etc.
- **Expressing Gratitude**
- Thank you (very much). Thanks (a lot).
- **Replying to Gratitude**
- Sure. You're welcome. No problem.
- **Attracting Attention**
- Look. Listen. Excuse me. Pardon me. Hello, can you help me?
- **Praising, Congratulating, and Admiring**

**Praising**

- (Very) Good! Good (for you)! Well done!

**Congratulating**

- Happy birthday (to you)! Congratulations!

### **Replying to Praise**

- How nice (of you)!

### **Exclamation**

- What a nice ... ! How... she is!

### **Encouragement**

- Good luck! Don't worry.

### **Making an Appointment**

### **Suggesting an Appointment**

- How about ... ? What about ... ? Let's ... .

### **Replying to Suggestions**

- Sure. Okay./OK. Why not? No problem. Of course.

### ***Formimi Gjuhësor (grammar)***

- Simple Present (study, go, work, etc.)
- Present Continuous (I am writing, you are speaking, he is sleeping, etc.)
- Prepositions of location (in, on, near, under, etc.)
- Adverbs of frequency and manner (sometimes, often, always, never, etc.)

- Modals (can, may, should, would etc.)
- Have/have got, “have” idiomatic expressions (I have got a brother; I have breakfast at 7.30. etc.)
- Word order (subject+verb+object) eg. I am a student. etc.
- Adjectives (opposites) (white/black; heavy/light; left/right;). Etc.
- Count and noncount nouns. (a book, a pen, a chair, water, bread etc.)
- Possessive adjectives (my, your, his, her, its, our, their)
- Possessive case (Ana’s book, Vera’s friend, etc.)
- Personal pronouns (objective, subjective)
- Comparison of adjectives (positive, comparative, superlative) (short-shorter-the shortest) etc.
- Simple past (regular and irregular verbs) Come/came; go/ went; work/worked
- Past continuous - I was going to school.
- Future with shall and will - I will go to London next year.
- Comparison of adjectives. (longer adjectives, irregular forms etc)  
more beautiful/ more handsome; better/worse
- Prepositions of location - Next to, opposite, around, under, over, between
- Adverbs - Happily/carefully/quickly; never/sometimes/often/always
- Pronouns - Someone/somebody/something/anything/anyone/nothing/no one.
- Modals - Should / shouldn't
- Idiomatic have - Have breakfast/super; Have a cold/a walk/ Have a headache.
- Word order (subject, verb, object.) I study English.
- Plurals of irregular nouns - Man/men; Child/children; Foot/feet
- Possessive forms - Pupil's boks/ Children's toys
- Adjectives + preposition- Good at; interested in; afraid of